



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 469/01 Prot

Datë 19.04 2017

**Lënda:** Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë

**Drejtuar:** **Z. Dritan LELI**  
Kryetar  
Bashkia Vlorë

**Bashkimi i Operatorëve ekonomik DEA studio shpk dhe Thymio Papayannis Associates (TPA) SA**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", "Kullat Binjake", "Kulla 1", kati 3, Tiranë*

*Të nderuar Zotërinj,*

Në vijim të shkresës Suaj me Nr. 2689 Prot., datë 04.04.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 469 Prot., datë 04.04.2017, me lëndë: "Dërgim informacioni", në lidhje me dorëzimin e dokumenteve të Fazës I dhe Fazës II të Draft PPV-së të Bashkisë Vlorë, për pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë dhe botimit të dokumenteve në Regjistër, më datë 23.03.2017, Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka kryer kontrollin e përputhshmërisë sipas legjislacionit në fuqi në fushën e planifikimit dhe atij sektorial.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, lutemi gjeni vlerësimin dhe konkluzionet e nxjerra nga AKPT mbi Draft-PPV-në e Bashkisë Vlorë.

Lutemi, reflektimin sa më parë të komenteve të AKPT-së sipas materialit bashkëlidhur dhe ridërgimin e dokumentit të plotë të PPV-së, për t'u pajisur më pas nga AKPT me Aktin e Përputhshmërisë.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, bazuar në Nenin 51, të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", dokumenti i plotë i PPV-së përmban:

- 1. Bazën e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të regjistrit të integruar të territorit;**

**2. Strategjinë territoriale, që përfshin:**

- a) dokumentin e analizës metabolike të territorit;
- b) planin e veprimeve strategjike/prioritare, investimeve kapitale dhe projektet pilot të zhvillimit;
- c) Materiali hartografik;

**3. Planin e zhvillimit të territorit, që përfshin:**

- a) dokumentin e analizës së thelluar të territorit;
- b) propozimin me përcaktime territoriale në bazë të 5 sistemeve;
- c) Materiali hartografik;
- ç) relacionin e propozimeve;
- d) vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e PPV-së;
- dh) planin e veprimeve, investimeve dhe projekteve për zbatimin e PPV-së;
- e) treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së.

**4. Rregulloren e zbatimit të PPV-së.**

**5. Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe të ndikimit në mjedis.**

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi, punoi: S. Meta


Datë 19.04.2017

Kopie Nr. 3

## Komente mbi draft Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë.


Përmbajtja:

1. Koded e njësive “Harta 18i - Harta e Njësive Strukturore”.
2. Propozime (*të reja*) brenda Vijës Blu.
3. Propozime (*për rigjenerim / dendësim*) brenda Vijës Blu.
4. Propozime brenda “Brezit Bregdetar” (*sipas PPK*).
5. Propozime (*të reja*) brenda Zonave të Mbrojtura.
6. Propozime të cilat nuk janë në përputhje me gjendjen ekzistuese.
7. Komente mbi Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, Vlorë.
8. Databaza GIS.
9. Parime të Përgjithshme.



### 1. Kodet e njësive “Harta 18i - Harta e Njësive Strukturore”

- Kodet identifikues të njësive në të njëjtën zonë duhet të jenë sipas një rendi progresiv.
- Kodet identifikues të njësive duhet të jenë të lexueshëm.
- Për tregimin e tyre në hartën përkatëse sugjerohet të merret parasysh shembulli i mëposhtem.



*Shembull për kodifikimin e njësive*

